

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 850 Prot.

Tiranë, më 19.06 2017

VENDIM Nr. 123, datë 05.06.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, datë 05.06.2017, pasi shqyrtoi Relacionin e verifikimit në terren në kuadër të projektit "*Rikonstruksion dhe shtesë anësore e godinës së administratës në Njësinë e Prodhimit HEC KOMAN*"-subjekti KESH sh.a., realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

VENDOSI:

1. Të miratojë Relacionin e verifikimit në terren në kuadër të projektit "*Rikonstruksion dhe shtesë anësore e godinës së administratës në Njësinë e Prodhimit HEC KOMAN*"-subjekti KESH sh.a., realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.
2. Në rast se gjatë zbatimit të punimeve identifikohen gjetje arkeologjike, bazuar në nenin 48 të ligjit 9048, datë 7.4.2003 "Për Trashëgiminë kulturore" (i ndryshuar), subjekti zbatues duhet të ndërpresë menjëherë punimet dhe të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Shkodër dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

